



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.194

dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 203 datë 23.12.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve dhe të protokollit të saj për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve gjatë qarkullimit në zonat kufitare”	8547
Ligj nr.10 204 datë 23.12.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ripranimin e personave”	8559
Ligj nr.10 205 datë 23.12.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm”	8563
Ligj nr.10 206 datë 23.12.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve”	8570
Ligj nr.10 207 datë 23.12.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar	8573
Ligj nr.10 208 datë 23.12.2009	Për disa shtesa në ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”	8576
Ligj nr.10 209 datë 23.12.2009	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	8578
Ligj nr.10 210 datë 23.12.2009	Për një shtesë në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar	8581
Ligj nr.10 211 datë 23.12.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tachograph digital në Shqipëri”	8582

LIGJ
Nr.10 203, datë 23.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE DHE TË PROTOKOLLIT TË SAJ PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE GJATË QARKULLIMIT NË ZONAT KUFITARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve dhe të protokollit të saj për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve gjatë qarkullimit në zonat kufitare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6379, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në emër të shteteve të tyre përkatëse, më poshtë të quajtura “Palë kontraktuese”;

Të nisura nga dëshira për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore që tashmë ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

Duke konfirmuar se respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe humanizmit përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes;

Me synimin për të lehtësuar kontaktet e shtetasve me njëri-tjetrin si një instrument i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve dhe mbështetjes për zhvillim në të gjitha fushat e veprimtarisë;

Të bindura se liria e lëvizjes njerëzore përbën një zhvillim themelor për forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve të secilit vend për integrimin në Bashkimin Europian;

janë marrë vesh si më poshtë:

Neni 1

1.Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, të shërbimit/zyrtarë ose pasaportave të zakonshme përjashtohen nga detyrimi për t’u pajisur me vizë

hyrëse në territorin e palës tjetër kontraktuese për një vizitë ose qëndrim jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes së parë.

2.Shtetasit e secilit vend hyjnë, kalojnë tranzit, qëndrojnë përkohësisht dhe largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese në të gjitha pikat e kalimit kufitar të hapura për qarkullimin ndërkombëtar dhe ndërshtetëror, duke pasur një dokument të vlefshëm udhëtimi si ato që listohen në shtojcën e kësaj marrëveshjeje.

3.Shtetasit e secilit vend, hyjnë, kalojnë, qëndrojnë përkohësisht dhe largohen nga territori i secilës palë kontraktuese pa taksa dhe tarifa për periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

1.Shtetasit e palëve kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit/zyrtare, të lëshuara nga Ministritë e Punëve të Jashtme të palëve kontraktuese, mund të hyjnë, të kalojnë tranzit, të qëndrojnë dhe largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pa vizë, për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditore nga data e hyrjes së parë.

2.Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit/zyrtare, të cilët janë pjesëtarë të stafit të një misioni diplomatik ose një posti konsullor, të një organizate ndërkombëtare, të një shërbimi tregtar dhe ekonomik brenda misionit diplomatik ose një qendër e informacionit kulturor, e krijuar mbi bazën e një marrëveshjeje ndërqeveritare, të cilat ndodhen në territorin e palës tjetër kontraktuese, hyjnë në territorin e saj pa vizë, pas njoftimit zyrtar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Akreditimi vijon në përputhje me procedurën e brendshme të palës kontraktuese pritëse. Ata qëndrojnë pa vizë, deri në largimin e tyre nga territori i palës kontraktuese pritëse gjatë gjithë periudhës së akreditimit të tyre.

3.Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni shtrihen deri te pjesëtarët e familjes së shtetasve në fjalë: bashkëshorti(ja), fëmijët nën moshën 26 vjeç, të cilët nuk kanë kryer martesë civile dhe që vazhdojnë mësimet me kohë të plotë në institucionet arsimore në territorin e palës kontraktuese pritëse dhe që jetojnë së bashku me ta gjatë mandatit të tyre në detyrë, nëse janë mbajtës të pasaportave diplomatike ose shërbimi/zyrtar.

4.Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk zbatohen për personat që mbulon paragrafi 3, kur ata janë shtetas të një vendi të tretë, për të cilët palët kontraktuese zbatojnë regjimin e vizave. Në këtë rast, personat në fjalë pajisen me llojin përkatës të vizës që në hyrjen e tyre të parë në territorin e palës kontraktuese pritëse.

Neni 3

Qarkullimi në zonat kufitare ndërmjet palëve kontraktuese rregullohet nga protokollin i kësaj marrëveshjeje, i cili është pjesë përbërëse e saj.

Neni 4

Shtetasit e palëve kontraktuese, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë për periudha më të gjata kohore në territorin e palës tjetër kontraktuese për qëllime studimi, punësimi, bashkimi familjar etj., u referohen dhe respektojnë dispozitat e legjislacionit të brendshëm të palës tjetër kontraktuese.

Neni 5

Në rast se për shkaqe të forcës madhore, një shtetas nuk ka mundësi për t'u larguar nga territori i palës tjetër kontraktuese, atëherë brenda afatit të vlefshmërisë së qëndrimit, pala kontraktuese pritëse do ta bëjë falas zgjatjen e lejes së qëndrimit.

Neni 6

Shtetasit e palëve kontraktuese që qëndrojnë në territorin e palës tjetër kontraktuese për periudha të shkurtra kohore nuk kanë të drejtën e punësimit.

Neni 7

Shtetasit e secilës palë kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese, veprojnë në përputhje me legjislacionin e kësaj të fundit.

Neni 8

Secila palë kontraktuese mund t'u refuzojë hyrjen ose të shpallë të pavlefshëm qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të palës tjetër kontraktuese, të cilët ajo, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i gjykon si të papranueshëm ose të padëshirueshëm.

Neni 9

Kur shtetasit e palës kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese, humbin pasaportat e tyre ose dhe ndonjë dokument tjetër zëvendësues udhëtimi, njoftojnë menjëherë për këto raste autoritetet përkatëse vendore, të cilët do t'u lëshojnë një dokument njoftues ndihmës. Misioni diplomatik ose përfaqësia konsullore e shtetit të shtetësisë do t'i pajisë ata me një dokument të ri të përshtatshëm udhëtimi. Të dy këto dokumente, dokumenti i ri dhe ai njoftues duhet të paraqiten në pikat e kalimit kufitar.

Neni 10

1. Palët kontraktuese do të këmbëjnë specimenet e dokumenteve të tyre të vlefshme të udhëtimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kur njëra palë kontraktuese lëshon një model të ri të dokumentit të udhëtimit apo i modifikon dokumentet tashmë të këmbëyer, për këto modifikime duhet të njoftohet pala tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së hyrjes në qarkullim të dokumentit të ri ose të modifikuar. Ky njoftim duhet të përfshijë modelin e dokumenteve të reja ose të modifikuara dhe informacione mbi zbatueshmërinë e tyre.

Neni 11

1. Palët kontraktuese do të krijojnë një komitetit të përbashkët, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, i cili ka për detyrë monitorimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që rrjedh nga interpretimi apo zbatimi i dispozitave të marrëveshjes. Komiteti do të mbledhet sa herë që të jetë e nevojshme, me kërkesën e njëres nga palët kontraktuese.

Neni 12

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve kontraktuese. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të nenit 14 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

1. Secila nga palët kontraktuese mund ta pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, veprimin e kësaj marrëveshjeje, në rastin e një fatkeqësie natyrore, epidemie apo për shkak të konsideratave të

sigurisë dhe rendit publik, duke njoftuar menjëherë palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i veprimit të kësaj marrëveshjeje hyjnë në fuqi nga data e marrjes së këtij njoftimi.

2. Pala që ka marrë masat e treguara në paragrafin 1 të këtij neni njofton menjëherë palën tjetër kontraktuese për këtë shfuqizim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 14

1. Kjo marrëveshje dhe protokoli i saj është i vlefshëm për një periudhë të papërcaktuar kohore, ato hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Secila prej palëve kontraktuese mund ta përfundojë vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje ose pjesëve të saj, duke njoftuar me shkrim palën tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast marrëveshja ose pjesë të saj do të pushojnë së vepruari pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Prishtinë, më 6.10.2009, në dy kopje origjinale, secila në shqip, serbisht dhe anglisht, duke pasur secili nga tekstet fuqi të barabartë. Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim, epërsi do të ketë teksti në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë

Sali Berisha

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Hashim Thaçi

SHTOJCË

E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, dokumente të vlefshme udhëtimi konsiderohen:

1. Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë:
 - a) pasaportë e zakonshme;
 - b) pasaportë diplomatike;
 - c) pasaportë shërbimi;
 - d) letërnjoftim.
 - e) dokument i vlefshëm udhëtimi për kthimin në Republikën e Shqipërisë;
 - f) leje për qarkullim në zonat kufitare;
 - g) dokumente udhëtimi të lëshuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme për palët kontraktuese.
2. Për shtetasit e Republikës së Kosovës:
 - a) pasaportë e zakonshme;
 - b) pasaportë diplomatike;
 - c) pasaportë zyrtare;
 - d) letërnjoftim;
 - e) dokument udhëtimi grupi;
 - f) dokument i vlefshëm udhëtimi për kthimin në Republikën e Kosovës;
 - g) leje për qarkullim në zonat kufitare
 - h) dokumente udhëtimi të lëshuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme për palët kontraktuese.

PROTOKOLL
I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI LËVIZJEN E
NDËRSJELLË TË SHTETASVE GJATË QARKULLIMIT NË ZONAT KUFITARE

Neni 1

Ky protokoll vendos regjimin e qarkullimit në zonat kufitare ndërmjet kufijve shtetërore të dy vendeve, më poshtë të quajtura “Palë kontraktuese”.

Neni 2

Për qëllime të këtij protokollit përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. “Kufi shtetëror” nënkupton një kufi të përbashkët ndërmjet dy vendeve;
2. “Zonë kufitare” nënkupton një zonë në territorin e palës kontraktuese, e cila ndodhet jo më larg se 20 km nga vija kufitare. Njësitë vendore administrative brenda kësaj zone do të konsiderohen pjesë të zonës kufitare, ashtu siç tregohet në aneksin A. Në rast se ndonjë pjesë e kësaj njësie do të ndodhet mbi 20 km larg nga vija kufitare, por jo më larg se 30 km, ajo sërisht konsiderohet si pjesë e zonës kufitare;
3. “Përfituesit” janë shtetasit e palëve kontraktuese, të cilët të paktën për një vit janë banues të ligjshëm në një zonë kufitare dhe që kanë të drejtë të pajisen dhe të përdorin një leje për qarkullim kufitar vendor;
4. “Leja për qarkullim kufitar” nënkupton një dokument të vlefshëm udhëtimi, i cili lejon përfituesin të kalojë kufirin shtetëror dhe të qëndrojë në zonën kufitare të palës tjetër kontraktuese, ashtu siç përcaktohet në këtë protokoll;
5. “Qarkullimi në zonat kufitare” është lëvizja e rregullt tejkuftare që kryhet nga përfituesit me qëllime udhëtimi ose qëndrimi në zonën kufitare të palës tjetër kontraktuese, për arsye kulturore, ekonomike ose familjare, për një periudhë të caktuar kohe, e cila përcaktohet në këtë protokoll.

Neni 3

1. Përfituesit që zotërojnë një leje të vlefshme për qarkullim në zonat kufitare mund të udhëtojnë dhe qëndrojnë në zonën kufitare të palës tjetër kontraktuese deri në 7 (shtatë) ditë rresht.
2. Gjatë qëndrimit të tyre, që përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, përfituesit mund të merren me veprimtari fitimprurëse, duke përfshirë veprimtari ditore ose të përkohshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palës kontraktuese.
3. Kohëzgjatja e përgjithshme e vizitave të tyre të radhës nuk mund të jetë më e madhe se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh.

Neni 4

1. Leja e qarkullimit në zonat kufitare lëshohet nga një autoritet kompetent shtetëror i palës kontraktuese, mbështetur në kërkesën e miratuar nga autoritetet kompetente të policisë kufitare vendore të palës tjetër kontraktuese, brenda 5 (pesë) ditë pune.
2. Leja jepet me një vlefshmëri kohore prej 5 vjetësh.
3. Leja përmban:
 - a) fotografinë e kërkuarit (me ngjyra) jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj, emrin dhe mbiemrin, datëlindjen, shtetësinë dhe vendbanimin;
 - b) autoritetin lëshues, datën e lëshimit dhe vlefshmërinë;
 - c) numrin e dokumentit mbi bazën e të cilit përcaktohet identiteti i kërkuarit;
 - d) data dhe fotografia e fëmijëve nën 14 (katërmëdhjetë) vjeç të përfituesit të lejes;
 - e) shpjegimin se zotëruesi i lejes mund të lëvizë lirisht vetëm në zonën kufitare dhe se në rast keqpërdorimi pasojnë sanksione.

4. Leja përfshin sa më shumë që të jetë e mundur karakteristikat mbrojtëse, në pajtim me standardet e Bashkimit Europian.

Neni 5

1. Palët kontraktuese mund të heqin dorë nga detyrimi për të vendosur në leje vula hyrëse dhe dalëse.

2. Për qëllime të evidentimit të hyrjes, daljes dhe qëndrimit, autoritetet e pikave të kalimit kufitar të palës kontraktuese, sipas rastit, mund t'u lëshojnë përfituesve një dëshmi të veçantë, në të cilën shënohet data, vendi dhe pika e kalimit kufitar ku është bërë kalimi i kufirit shtetëror.

Neni 6

Palët kontraktuese marrin në vazhdimësi masat e duhura për lehtësimin e kalimit të kufirit shtetëror. Këto masa përfshijnë:

a) Krijimin e pikave të veçanta të kalimit kufitar vetëm për përfituesit, në përputhje me legjislacionin kombëtar;

b) Rezervimin e linjave të veçanta për përfituesit në pikat e kalimit kufitar ndërkombëtar;

c) Mundësimin e përfituesve, sa herë që të jetë e nevojshme dhe në veçanti duke mbajtur parasysh rrethanat vendore, duke përfshirë dhe rastet e forcës madhore :

a) për të kaluar kufirin në vende ku nuk ka pika të kalimit kufitar dhe/ose jashtë orarit të shpallur punës;

b) për përfituesit që njihen nga oficerët e policisë kufitare për shkak të kalimit të tyre të shpeshtë të kufirit, sa herë që të jetë e nevojshme mund t'u nënshtrohen kontroleve rutinore.

Neni 7

Përfituesit e secilës palë kontraktuese, që gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese humbasin lejen, duhet të njoftojnë për këtë rast menjëherë autoritetet e policisë vendore, të cilat me këtë rast lëshojnë një dokument njoftimi ndihmës. Ky dokument njoftues duhet të paraqitet në pikën e kalimit kufitar.

Neni 8

Ky protokoll zbatohet në të gjitha pikat e tanishme dhe të ardhshme të kalimit kufitar ndërkombëtar, si dhe në pikat vendore të kalimit kufitar. Lista e të gjitha pikave të kalimit kufitar tregohet në anekset bashkëlidhur.

Neni 9

1. Përfituesit nuk mund të udhëtojnë apo të qëndrojnë jashtë zonës kufitare të përcaktuar në këtë protokoll.

2. Mosrespektimi i kësaj dispozite konsiderohet qëndrim i paligjshëm dhe i nënshtrohet masave të duhura në pajtim me legjislacionin kombëtar të secilës palë kontraktuese. Kjo mund të përfshijë edhe anulimin e lejes nga autoriteti lëshues, për një periudhë kohore prej jo më pak se një vit.

3. Palët kontraktuese shkëmbejnë rregullisht informacione mujore mbi përfituesit që janë objekt i masave në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

Bërë në Prishtinë, më 6.10.2009 në dy kopje origjinale, secila në shqip, serbisht dhe anglisht, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë. Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim, epërsi ka teksti në gjuhën angleze.

SHTOJCË

E PROTOKOLLIT TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE GJATË QARKULLIMIT NË ZONAT KUFITARE

Për qëllime të këtij protokollit të marrëveshjes, emrat zyrtarë të fshatrave kufitarë që ndodhen në rrezen 20 km nga kufiri Shqipëri-Kosovë konsiderohen:

Për Republikën e Shqipërisë

Rrethi Kukës

I.Komuna Bicaj

Bicaj

Bushat

Domaj

Gabrricë

Kolesjan

Mhole

Mustafaj

Nange

Osmanaj

Tershene

II.Komuna Kukës

Kukës

Drinas

Kulla e Lulës

III.Komuna Bushtricë

Baruç

Bushtricë

Gjegje

Matranxh

Palush

Shpat

IV.Komuna Bushtricë

Vilë

V.Komuna Orgjost

Bele

Kosharisht

Lojme

Orçikel

Orgjost

Pakisht

Zapod

VI.Komuna Shistavec

Borje

Cernalevë

Kollovoz
Novoseje
Shishtavec
Shtreze

VII.Komuan Shtiqen
Shtiqen
Kodër Lume
Krenez
Shtiqen
Muje

VIII.Komuna Terthore
Bardhoc
Bardhoc i Ri
Breg lume
Gjegjan
Morinë
Pobreg

IX.Komuna Topojan
Brekije
Topojan
Turaj
Xhaferaj

X.Komuna Ujmisht
Lusen
Malqene
Resk
Skavicë
Tejdrine
Ujmisht

XI.Komuna Ujmisht-Kukës
Zall Lusen

Rrethi Has
I.Komuna Fajza
Fajze
Liqeni i Kuq
Metaliaj
Tregtan
Vranisht

II.Komuna Golaj
Dobrunë
Golaj
Helshan
Letaj
Nikoliq
Peraj

Perrollaj
Qarr
Vlahen
Zgjeç
Bardhaj

III.Komuna Gjinaj
Domaj Has
Gjinaj
Kishaj
Myç Has
Pogaj
Pus i Thatë

IV.Komuna Krume
Cahan
Gajrep
Krume
Krume-fshat
Mujaj
Plani i Patës
Zahrisht

Rrethi Tropojë
I.Komuna Bajram Curr
Bajram Curri

II.Komuna Bujan
Dilate
Bujan
Dojan
Gri
Gri e Re
Lekurtaj
Markaj
Rosuj
Selimaj

III.Komuna Bytyç
Berishë
Bytyç
Çorr Viliq
Kam
Kepenek
Leniq
Mash
Pac
Prush
Visoçe
Vlad
Zherkë
Zogaj

IV.Komuna Llugaj

Bukovë
Cernicë
Llugaj
Lushë
Rrëzë Mali
Rragam

V.Komuna Tropojë Fshat

Bebine
Begaj
Buçaj
Gegaj
Kasaj
Kërrnajë
Kovaçë
Myhejan
Papaj
Shkëlzen
Sumacë Ahmataj
Sopot
Viçidol
Kojel
Astë

2.Pika kalimi kufitare, për këmbësorë, me orare të reduktuara, 4 orë në ditë (2+2) nga ana shqiptare mund të jenë:

- | | |
|---------------|-----------------|
| 1.Borje | piramida D17 |
| 2.Zapod | piramida D14/17 |
| 3.Dobrunë | piramida D1 |
| 4.Qafë Gjonaj | piramida C9 |
| 5.Padeshi | |

Për Republikën e Kosovës:

Rajoni i Gjakovës

Mulliq	DM 400-987
Potok Mulliq	DM-376-985
Brovinë	DM 404-978
Potok Morinë	DM-378-967
Morinë	DM-389-959
Ponoshec	DM-41 0-952
Popoc	DM-421-934
Shishman	DM-443-920
Babaj t'Bokës	DM-451-901
Qerret	DM-396-877
Guskë	DM-483-900
Devë	DM-466-885
Vogovë	DM-495-885
Firzë	DM-522-888
Gërçinë	DM-574-826
Damjan	DM-605-827

Zhub	DM-502-878
Kusar	DM-540-863
Zylfaj	DM-508-834
Goden	DM-542-828
Lipovec	DM-563-846

Rajoni i Prizrenit

Kushnin	DM-618-804
Kabashi i Hasit	DM-632-800
Lubizhda e Hasit	DM-649-728
Gjonaj	DM-685-774
Planej	DM-653-735
Milaj	DM-637-719
Gorozhub	DM-625-694
Vermica	DM-639-674
Shkoza	DM-661-679
Dedaj	DM-645-813
Lubishda	DM-813-766
Romaj	DM-664-822
Lukinaj	DM-681-828
Krajk	DM-720-811
Mazrek	DM-684-759
Kojushë	DM-678-750
Nashec	DM-713-765
Atmaxhe	DM-721-757
Tupec	DM-724-781
Landovicë	DM-739-793
Piranë	DM-732-825
Krushë e Vogël	DM-712-840
Grazhdanik	DM-721-737
Kobaj	DM-703-738
Murademe	DM-704-719
Vlashnje	DM-721-724
Poslisht	DM-728-696
Hoqe e Qytetit	DM-744-695
Malësi e Vrrinit	DM
Leskovec	DM-775-693
Zhur	DM-687-680
Dobrusht	DM-661-699
Plavë	DM-707-604

Rajoni i Dragashit

Brezne	DM-695-634
Buge	DM-697-622
Rapga	DM-681-600
Kërstaci i Madh	DN-538-190
Kërsteci i Vogël	DM-665-572
Vranishtë	DM-693-546
Orgushë	DM-668-546
Gilboqicë	DM-690-504
Krushevë	DM-702-476
Gilboqica II	DM-661-404

Restelica	DM-724-438
Brod	DM-756-491
Zaplluzha	DM-801-644
Mlik	DM-705-530
Zli Potok	DM-718-474
Kukajan	DM-720-547
Brodosanë	DM-771-620
Xerzë	DM-735-588
Shajne	DM
Rence	DM-720-598
Zym	DM-725-626
Blaq	DM-778-636
Bellobrad	DM-737-629
Brut	DM-751-640
Zgatar	DM-760-640
Kapre	DM-744-613
Buzec	DM-757-619
Kuk	DM-763-610
Kosav	DM-750-602
Plajnik	DM-758-584
Kuklibeg	DM-773-615

Rajoni i Deçanit	
Gryka e Deçanit	DN-284-164
Hulaj	DN-394-094
Pobërgjë	DN-393-034
Voksh	DN-401-056
Gjocaj	DN -383-039
Jasiq	DN -478-022
Koshare	DN -373-005
Batushë	DN -393-005

LIGJ
Nr.10 204, datë 23.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ripranimin e personave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6380, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës (të quajtura më poshtë “Palët kontraktuese”),

me dëshirën për të zhvilluar marrëdhënie miqësore midis të dy shteteve,

të udhëhequr, nga qëllimi për të bashkëpunuar në bazë të reciprocitetit në trajtimin e çështjeve të ripranimit të personave që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e palës tjetër kontraktuese,

me dëshirën për të kontribuar në këtë mënyrë në parandalimin e lëvizjes së paligjshme të personave dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit europian, si dhe në përputhje me interesat reciproke,

ranë dakord për sa vijon:

I
RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 1

1. Secila palë kontraktuese do të ripranojë në territorin e saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese dhe pa formalitete të tjera, personin që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se personi zotëron shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar. Përgjigjja e palës kontraktuese të kërkuar në lidhje me ripranimin e personit do të dërgohet pa vonesë, por jo më vonë se 28 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës për ripranim.

2. Pala kontraktuese kërkuese do ta ripranojë personin e referuar në paragrafin 1 sipas të njëjtave dispozita, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i shtetit të palës kërkuese, ai/ajo nuk zotëronte shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

3. Në rastin kur personi i përmendur në paragrafin 1 transferohet dhe ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër kontraktuese.

Neni 2

1. Nëse shtetësia është provuar ose prezumuar në mënyrë të vlefshme, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do ta lëshojë pa vonesë, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, një dokument udhëtimi zëvendësues që është i nevojshëm për kthimin e personit që do të transferohet në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të intervistojë personin brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga dorëzimi i kërkesës për ripranimin e personit. Nëse intervistimi tregon se personi ka shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument udhëtimi zëvendësues.

II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 3

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e palës kontraktuese kërkuese nuk arrin t'i përmbushë kushtet paraprake në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit do ta ripranojë atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa asnjë formalitet.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese kanë lëshuar një vizë ose një lejeqëndrimi, detyrimi për ta ripranuar personin do t'i takojë asaj pale kontraktuese, vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit të së cilës mbaron më vonë.

Neni 4

1. Pala kontraktuese e kërkuar do të ripranojë një shtetas të vendeve të treta apo person pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese, nëse kjo e fundit provon apo prezumon vlefshmërisht se personi i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim e ka kaluar kufirin shtetëror të palës kontraktuese kërkuese, pasi ka qëndruar në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1 nuk do të zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese kishte një lejeqëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i ishte dhënë lejeqëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj.

3. Palët kontraktuese do të bëjnë përpjekje, sipas parapëlqimeve, për të transferuar një shtetas të një vendi të tretë për në shtetin e tij/saj të origjinës.

4. Pala kontraktuese kërkuese do ta ripranojë një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi nën të njëjtat kushte nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nuk plotësoheshin kushtet në kuadrin e nenit 3 paragrafi 1 dhe nenit 4 paragrafi 1.

Neni 5

Detyrimi për të ripranuar sipas neneve 3 dhe 4 nuk do të zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

a) të cilit i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuuese, në bazë të konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për statusin e refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967);

b) i cili është transferuar më parë nga pala kontraktuese e kërkuar për në shtetin e origjinës ose në ndonjë shtet tjetër;

c) shteti i të cilit ka kufi të përbashkët me shtetin e palës kontraktuese kërkuuese;

d) që ka qëndruar në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuuese për më shumë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë.

III

PRANIMI TRANZIT I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 6

1. Secila nga palët kontraktuese, me kërkesë me shkrim të palës tjetër, autorizon tranzitimin në territorin e vet të shtetasve të vendeve të treta, të cilët i janë nënshtruar masës së largimit të ndërmarrë nga pala kontraktuese kërkuuese. Tranziti mund të kryhet në rrugë tokësore ose ajrore.

2. Pala kontraktuese kërkuuese është përgjegjëse për vazhdimin e mëtejshëm të udhëtimit të shtetasit të një vendi të tretë drejt vendit të destinacionit dhe rimerr përsipër shtetasin në fjalë, nëse për çfarëdo arsye ripranimi i tij nuk zbatohet.

3. Pala kontraktuese kërkuuese i garanton palës kontraktuese të kërkuar që shtetasi i vendit të tretë, për të cilin autorizohet tranziti, ka një dokument (biletë) udhëtimi për në vendin e destinacionit.

4. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore pala kontraktuese e kërkuar mund të sigurojë, nëse është e nevojshme, mbikëqyrjen e personit në zonën tranzit të aeroportit dhe sistemin e tij në bord të avionit, në marrëveshje me personelin shoqërues të palës kontraktuese kërkuuese.

Neni 7

1. Tranziti mund të refuzohet nëse një shtetas i një vendi të tretë është në rrezik për:

a) persekutim në vendin e destinacionit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të pikëpamjeve të tij/saj politike;

b) ndjekje penale në vendin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një vepër penale të kryer para se të ndodhte tranziti;

c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të palës kontraktuese të kërkuar.

IV

SHPENZIMET

Neni 8

1. Shpenzimet që lidhen me ripranimin e personave sipas nenit 1 paragrafi 1 dhe nenit 4 paragrafi 1 deri në momentin që kryhet marrja në dorëzim e personit nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar, mbulohen nga pala kontraktuese kërkuuese. Shpenzimet në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuuese.

2. Shpenzimet e transferimit të një shtetasi të një vendi të tretë deri në kufirin e vendit të destinacionit, duke përfshirë shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, si edhe shpenzimet që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga pala kontraktuese kërkuuese.

V

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 9

1. Të dhënat personale të komunikuara, të cilat janë të nevojshme për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të mbrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palëve kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale ndërmjet palëve kontraktuese, për personat, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të pranohet, të të afërmeve të tij/saj (emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti ose dokumente udhëtimi dhe lejkalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet apo do të pranohet;

d) vendin e qëndrimit dhe itinerarin;

e) lejeqëndrimi ose viza të lëshuara nga njëra prej palëve kontraktuese.

VI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës do të lidhin një protokoll zbatimi, në të cilin ato do të specifikojnë:

a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e shtetasve të palëve kontraktuese;

b) përmbajtjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitim, mënyrën e paraqitjes dhe përpunimit të tyre;

c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;

d) autoritetet kompetente të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje;

e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

1. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, të autorizuar për të zbatuar këtë marrëveshje, bashkëpunojnë dhe konsultohen drejtpërsëdrejti.

2. Në rast vështirësish në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për konsultim duhet të paraqitet përmes kanaleve diplomatike.

3. Secila palë kontraktuese do të caktojë të paktën dy ekspertë për të vlerësuar realizimin e marrëveshjes dhe, nëse është e nevojshme, për të paraqitur propozime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e saj. Në të tilla shqyrtime mund të ftohen gjithashtu edhe ekspertë të tjerë për fusha të interesuara.

Neni 12

1. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk cenojnë detyrimet në lidhje me pranimin ose transferimin e shtetasve të vendeve të treta, detyrime që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare për palët kontraktuese.

2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e dispozitave të konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për statusin e refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967),

3. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e marrëveshjeve të firmosura nga palët kontraktuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 13

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas ditës së shkëmbimit të njoftimeve nga palët kontraktuese, nëpërmjet të cilëve ato njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila palë kontraktuese mund ta pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, me përjashtim të nenit 1, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Palët kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit të palës tjetër kontraktuese.

3. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, marrëveshja do të përfundojë në ditën e nëntëdhjetë pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin, palës tjetër kontraktuese.

Bërë në Prishtinë, më 6.10.2009, në dy kopje origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, serbe dhe në gjuhën angleze, të dy tekstet të barasvlefshme. Në rast mospërputhjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.10 205, datë 23.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE, HYRJA OSE QËNDRIMI I TË CILËVE ËSHTË I PALIGJSHËM”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6381, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARREVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE, HYRJA OSE QËNDRIMI I
TË CILËVE ËSHTË I PALIGJSHËM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Malit të Zi (të quajtura më poshtë “Palët kontraktuese”),

me dëshirën për të vazhduar bashkëpunimin me qëllim garantimin e zbatimit më të mirë të rregulloreve për fluksin e personave,

me dëshirën për të lehtësuar ripranimin dhe tranzitin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm,

në frymën e bashkëpunimit në bazë të reciprocitetit,

duke pasur parasysh konventën europiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut të adoptuar në Romë, më 4 nëntor 1950 dhe konventën që flet për statusin e refugjatëve të 28 korrikut 1951, të amenduar dhe shtuar nga protokolli në lidhje me statusin e refugjatëve, të adoptuar në Nju Jork më 31 janar 1967;

të vensosura për të parandaluar migracionin e paligjshëm,

ranë dakord për sa vijon:

I

PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

b) “Shtetas i Malit të Zi” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Malit të Zi, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

c) “Shtetas i vendit të tretë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësi të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi.

d) “Person pa shtetësi” do të thotë çdo person i cili nuk zotëron shtetësinë e asnjë shteti.

e) “Leje qëndrimi” do të thotë një leje e çdo tipi, e lëshuar nga Republika e Shqipërisë ose Mali i Zi, që i jep të drejtë një personi të qëndrojë në territorin e asaj pale kontraktuese. Kjo nuk do të përfshijë lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e shtetit të saj në lidhje me procedurat e aplikimit për azil ose një aplikimi për leje qëndrimi.

f) “Vizë” do të thotë një autorizim për të hyrë, qëndruar ose kaluar përmes territorit të saj, lëshuar nga njëra prej palëve kontraktuese, kjo nuk do të përfshijë vizën e tranzitit aeroportual.

g) “Shtet kërkues” do të thotë shteti që dorëzon një aplikim ripranimi, pranimi ose tranzitimi.

h) “Shtet i kërkuar” do të thotë shteti të cilit i drejtohet aplikimi për ripranim ose tranzit.

i) “Autoriteti kompetent” do të thotë çdo autoritet kombëtar përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

j) “Tranzit” do të thotë kalimi i një qytetari të një vendi të tretë ose personi pashtetësi përmes territorit të shtetit të kërkuar, ndërsa udhëton nga shteti kërkues drejt vendit të destinacionit.

k) “Ripranim” do të thotë transferimi nga shteti kërkues dhe pranimi nga shteti i kërkuar i personave (shtetas të shtetit të kërkuar, ose qytetarë të vendeve të treta ose persona pa shtetësi), të cilët kanë hyrë, qëndrojnë ose banojnë në palën kërkuese, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

II RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 2

1. Secila palë kontraktuese do të ripranojë në territorin e saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese dhe pa formalitete të tjera, një person që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se ky person ka shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Pala kontraktuese kërkuese do të ripranojë personin e përmendur në paragrafin 1 sipas të njëjtave kushte, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i palës kontraktuese kërkuese, ai/ajo nuk kishte shtetësinë e palës kontraktuese të kërkuar.

3. Në rastin kur personi i përmendur në paragrafin 1 synohet të transferohet dhe ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër kontraktuese. Përgjigjja e palës kontraktuese të kërkuar në lidhje me vendin dhe orën e ripranimit të personit do të dërgohet pa vonesë, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e njoftimit.

Neni 3

1. Nëse shtetësia është provuar ose prezumuar në mënyrë të vlefshme, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të lëshojë pa vonesë, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, një dokument udhëtimi zëvendësues që është i nevojshëm për kthimin e personit që do të transferohet në përputhje me nenin 1, paragrafi 1.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, bazuar mbi dokumentet e protokollit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, pala kontraktuese e kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar do të intervistojë personin brenda pesë (5) ditëve nga dorëzimi i kërkesës për ripranimin e personit. Pas miratimit të misionit diplomatik ose autoritetit konsullor, pala kontraktuese e kërkuar do ta kryejë këtë intervistim në kohën më të shkurtër të mundshme. Nëse intervistimi tregon se personi ka shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument udhëtimi zëvendësues.

III RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 4

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e palës kontraktuese kërkuese nuk arrin të përmbushë kushtet paraprake në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit do ta ripranojë atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa formalitete, përveç atyre të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe në protokollin zbatues përkatës.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese lëshuan një vizë ose një leje qëndrimi, detyrimi për të ripranuar personin do t'i takojë asaj pale kontraktuese, vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit të së cilës mbaron më vonë.

Neni 5

1. Pala kontraktuese e kërkuar do të ripranonjë një shtetas të vendeve të treta apo person pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese nëse kjo e fundit provon apo prezumon vlefshmërisht se personi i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim e ka kaluar kufirin shtetëror të palës kontraktuese kërkuese, pasi ka qëndruar në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1 nuk do të zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes së tij/saj në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese kishte një lejeqëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i është dhënë leje qëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj.

3. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të pranojnë pa formalitete dhe vonesë (më tutje procedura përmbledhëse), çdo qytetar të vendeve të treta ose person pa shtetësi, nëse qytetari i vendeve të treta ose personi pa shtetësi kapet në territorin e palës tjetër kontraktuese brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve që nga kalimi i paligjshëm i kufirit. Procedura përmbledhëse do të përdoret vetëm për rastet kur autoritetet kompetente të palës kontraktuese kërkuese mund të japin prova për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror të përbashkët nga ai person. Nëse një person refuzohet të pranohet sipas procedurës përmbledhëse, pranimi mund të kërkohej sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Nëse kushtet për ripranimin përmbledhës të personit janë përmbushur, autoritetet kompetente ose pala kontraktuese kërkuese do t'i njoftojë me faks, e-mail ose verbalisht autoritetet kompetente të palës kontraktuese të kërkuar. Një dosje mbi kthimin dhe pranimin e këtij personi duhet bërë.

5. Palët kontraktuese do të bëjnë përpjekje, sipas parapëlqimeve, për të transferuar një shtetas të një vendi të tretë për në shtetin e tij/saj të origjinës.

6. Pala kontraktuese kërkuese do të ripranonjë një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi nën të njëjtat kushte, nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nuk plotësoheshin kushtet në kuadrin e nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 5 paragrafi 1.

Neni 6

Detyrimi për të pranuar sipas neneve 4 dhe 5 nuk do të zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

a) shtetasit nga vendet e treta, që u përkasin shteteve që kanë kufij të përbashkët shtetërorë me shtetin e palës kontraktuese kërkuese;

b) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, që ka vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të lëshuar nga pala kontraktuese kërkuese ose ata që pas hyrjes morën një leje qëndrimi për këtë shtet;

c) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, që në kohën e dorëzimit të aplikimit të ripranimit, kanë më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj qëndrim në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, vetëm nëse ai/ajo ka një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga pala kontraktuese kërkuese;

d) shtetasi nga vendet e treta ose personi pa shtetësi, të cilit me dekret të pakthyeshëm i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuese në bazë të konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe protokollit për statusin e refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967);

e) shtetasi nga vendet e treta, i cili lë territorin shtetëror të palës kontraktuese të kërkuar dhe hyn në territorin shtetëror të palës kontraktuese kërkuese nga territori shtetëror në të cilin pala kontraktuese kërkuese lejohet ta kthejë këtë person sipas marrëveshjes dypalëshe të ripranimit.

IV. TRANZITI

Neni 7

1. Secila nga palët kontraktuese, me kërkesë me shkrim të palës tjetër, lejon tranzitimin në territorin e vet të shtetasve të vendeve të treta dhe do të sigurojë marrjen në dorëzim deri në shtetin e destinacionit ose në një tjetër shtet tranzit.

2. Pala kontraktuese kërkuuese i garanton palës kontraktuese të kërkuar që personi, për të cilin autorizohet tranziti, ka një dokument dhe biletë udhëtimi për shtetin e destinacionit. Pala kontraktuese kërkuuese është përgjegjëse për tranzitin e shtetasit të një vendi të tretë gjatë gjithë rrugës deri në shtetin e destinacionit.

3. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore të shoqëruar me eskortë policie, pala kontraktuese kërkuuese do ta sigurojë këtë për aq sa eskorta policore e palës kontraktuese kërkuuese nuk del nga zona ndërkombëtare e aeroportit. Nëse tranziti me eskortë policore vazhdon përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, kjo palë kontraktuese do të sigurojë eskortë policore.

Neni 8

1. Tranziti mund të refuzohet nëse një shtetas i një vendi të tretë është në rrezik për:

a) nëse personi është në rrezik për të qenë subjekt i torturës ose trajtimit çnjerëzor, ose degradues, ose ndëshkimit, ose dënimit me vdekje, ose persekutimit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të pikëpamjeve të tij/saj politike në vendin e destinacionit ose një vendi tjetër tranzit;

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do të jetë subjekt i ndjekjes penale ose sanksioneve në vendin e destinacionit ose një vendi tjetër tranzit, me përjashtim të kalimit të paligjshëm të kufijve shtetërorë; ose

c) nëse personit i është dhënë masa e sigurisë ose masa mbrojtëse e largimit nga territori i shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Një person i pranuar për tranzit mund t'i kthehet palës kontraktuese kërkuuese, nëse provat referuar në paragrafin 1, hidhen poshtë më vonë.

V AFATET KOHORE

Neni 9

1. Pala kontraktuese e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesës me shkrim, pa vonesë, në çdo rrethanë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike që nga marrja e kërkesës. Në raste të veçanta, kur ka pengesa ligjore ose faktike, afati do të zgjatet me gjashtë (6) ditë pune. Nëse pas skadimit të afatit kohor të përmendur pala kontraktuese e kërkuar nuk përgjigjet, ripranimi do të quhet i pranuar. Çdo arsye për refuzimin e aplikimit të ripranimit duhet të jepet me shpjegim me shkrim.

2. Pala kontraktuese e kërkuar do ta pranojë pa vonesë personin, pranimi i të cilit është konfirmuar, në çdo rrethanë, jo më vonë se pesë (5) ditë pune që nga marrja e konfirmimit.

3. Pala kontraktuese e kërkuar do ta pranojë, pa vonesë, personin që ripranohet sipas procedurës përmbledhëse, në çdo rast jo më vonë se njëzet e katër (24) orë që nga marrja e konfirmimit të lajmërimit.

4. Në raste të veçanta, afati kohor i paragrafit 2 të këtij neni, në mënyrë që të eliminohen pengesat ligjore ose faktike, mund të shtyhet me gjashtë (6) ditë pune pas skadimit të afatit kohor referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Pala kontraktuese e kërkuar, që merr kërkesën për tranzit, sipas nenit 7 paragrafi 1 të kësaj marrëveshjeje, do të përgjigjet pa vonesë, në çdo rast jo më vonë se tri (3) ditë pune që nga marrja e kërkesës.

VI KOSTOT

Neni 10

1. Kostot që lidhen me ripranimin e personave sipas nenit 2, nenit 4 dhe 5 deri në momentin që kryhet marrja në dorëzim e personit nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar, mbulohen nga pala kontraktuese kërkuuese. Shpenzimet, në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar, mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuuese.

2. Kostot e transferimit të një shtetasi të një vendi të tretë deri në kufirin e vendit të destinacionit, duke përfshirë shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, si edhe kostot që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga pala kontraktuese kërkuuese.

VII MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 11

1. Të dhënat personale të komunikuar, të cilat janë të nevojshme për qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të mbrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palëve kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale ndërmjet palëve kontraktuese, për personat, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të ripranohet, të të afërmeve të tij/saj (emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti ose dokumente udhëtimi dhe lejkalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet apo do të ripranohet;

d) vendin e qëndrimit dhe itinerarin;

e) lejeqëndrimin ose viza të lëshuara nga njëra prej palëve kontraktuese.

VIII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 12

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme dhe e Administratës Publike e Malit të Zi do të lidhin një protokoll zbatimi, në të cilin ato do të specifikojnë:

a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e personit për t'u ripranuar;

b) përmbajtjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitimin, mënyrën e paraqitjes dhe përpunimit të tyre;

c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;

d) mënyrat për të provuar kalimin e paligjshëm të kufirit;

d) autoritetet kompetente të autorizuar për të zbatuar këtë marrëveshje;

e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 13

1. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Brenda 3 muajve që nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente do të formojnë një komitet të përbashkët për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ripranimin e personave me hyrje ose qëndrim të paligjshëm.

3. Autoritetet kompetente do të kenë një shkëmbim të rregullt informacioni mbi kushtet për hyrjen e qëndrimin e të huajve.

4. Palët kontraktuese do ta njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për të gjitha ndryshimet në lidhje me autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

1. Kjo marrëveshje nuk paragjykon detyrimet e palëve kontraktuese në lidhje me ripranimin e personave, që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që janë të detyrueshme për palët kontraktuese.

2. Kjo marrëveshje nuk paragjykon zbatimin e konventës për statusin e refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951), amenduar dhe shtuar me protokollin për statusin e refugjatëve (Nju-Jork, 31 janar 1967), dhe konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Romë, 4 nëntor 1950).

3. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk pengojnë zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara nga palët kontraktuese në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 15

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë (30) pas ditës së shkëmbimit të njoftimeve nga palët kontraktuese, nëpërmjet të cilëve ato njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila palë kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje, plotësisht ose pjesërisht, me përjashtim të nenit 2, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj. Pezullimi i zbatimit të marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit të palës tjetër kontraktuese.

3. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, marrëveshja do të skadojë në ditën e nëntëdhjetë (90) pas dorëzimit të njoftimit për përfundimin, palës tjetër kontraktuese.

Bërë në Podgoricë më 6.12.2009 në dy kopje origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, në gjuhën malazeze dhe në gjuhën angleze, të gjitha njëllë të barazvlefshme. Në rast interpretimi kontradiktor, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.10 206, datë 23.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6382, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI MBI LËVIZJEN E NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi, më poshtë të quajtura “Palë kontraktuese”;

Të nisura nga dëshira për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore që tashmë ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

Duke konfirmuar se respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe parimeve të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe humanizmit përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes;

Me synimin për të lehtësuar kontaktet e shtetasve me njëri-tjetrin si një instrument i rëndësishëm për forcimin e lidhjeve dhe mbështetjes për zhvillim në të gjitha fushat e veprimtarisë;

Të bindura se liria e lëvizjes njerëzore përbën një zhvillim themelor për forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve të secilit vend për integrimin në Bashkimin Europian;

janë marrë vesh si më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të specifikuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje do të përjashtohen nga detyrimi për t’u pajisur me vizë hyrëse në territorin e palës tjetër kontraktuese për një vizitë ose qëndrim deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes së parë.

2. Shtetasit e secilit vend do të hyjnë, do të kalojnë tranzit, do të qëndrojnë përkohësisht dhe do të largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese në të gjitha pikat e kalimit kufitar të hapura për qarkullimin ndërkombëtar dhe ndërshtetëror.

Neni 2

1. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të lëshuara nga Ministritë e Punëve të Jashtme të palëve kontraktuese, mund të hyjnë, të kalojnë tranzit, të qëndrojnë përkohësisht dhe të largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pa vizë, për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditore nga data e hyrjes së parë.

2. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të cilët janë pjesëtarë të stafit të një misioni diplomatik ose një posti konsullor, të një organizate ndërkombëtare, të një shërbimi tregtar dhe ekonomik brenda misionit diplomatik ose një qendër e informacionit kulturor, e krijuar mbi bazën e një marrëveshjeje ndërqeveritare, të cilat ndodhen në territorin e palës tjetër kontraktuese, fillimisht do të hyjnë në territorin e saj pa vizë dhe pasi të jenë regjistruar në përputhje me procedurën e brendshme të palës kontraktuese pritëse. Ata do të qëndrojnë pa vizë, deri në largimin e tyre nga territori i palës kontraktuese pritëse gjatë gjithë periudhës së akreditimit të tyre.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni shtrihen deri te pjesëtarët e familjes së shtetasve në fjalë: bashkëshorti (ja) partneri civil, fëmijët nën moshën 26 vjeç, të cilët nuk kanë kryer martesë civile dhe që vazhdojnë mësimet me kohë të plotë në institucionet arsimore në territorin e palës kontraktuese pritëse dhe që jetojnë së bashku me ta prindërit ose thënë ndryshe mbajtësit e pasaportave diplomatike ose të shërbimit gjatë mandatit të tyre në detyrë.

4. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të zbatohen për personat e përmendur në këtë paragraf, kur ata janë anëtarë të një vendi të tretë, për të cilët palët kontraktuese zbatojnë regjimin e vizave. Në këtë rast, personat në fjalë do të pajisen me llojin përkatës të vizës qysh në hyrjen e tyre të parë në territorin e palës kontraktuese pritëse.

Neni 3

Shtetasit e palëve kontraktuese, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë për periudha më të gjata kohore në territorin e palës tjetër kontraktuese për qëllime studimi, punësimi, bashkimi familjar etj., do t'u referohen dhe do të respektojnë dispozitat e legjislacionit të brendshëm të palës tjetër kontraktuese.

Neni 4

Në rast se për shkaqe të forcës madhore, një shtetas nuk ka mundësi për t'u larguar nga territori i palës tjetër kontraktuese, atëherë brenda afatit të vlefshmërisë së qëndrimit, pala kontraktuese pritëse do të bëjë falas zgjatjen e lejes së qëndrimit.

Neni 5

Shtetasit e palëve kontraktuese që qëndrojnë në territorin e palës tjetër kontraktuese për periudha të shkurtra kohore nuk do të kenë të drejtën e punësimit.

Neni 6

Shtetasit e secilës palë kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese do të veprojnë në përputhje me legjislacionin e kësaj të fundit.

Neni 7

Secila palë kontraktuese mund t'u refuzojë hyrjen ose ta shpallë të pavlefshëm qëndrimin në territorin e saj të shtetasve të palës tjetër kontraktuese, të cilët ajo, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i gjykon si të padëshirueshëm.

Neni 8

Kur shtetasit e palës kontraktuese, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër kontraktuese humbasin pasaportat e tyre ose dhe ndonjë dokument tjetër zëvendësues udhëtimi, ata do të njoftojnë menjëherë për këto raste autoritetet përkatëse vendore, të cilat nga ana e tyre, do t'u lëshojnë një dokument njoftues ndihmës. Misioni diplomatik ose përfaqësia konsullore e shtetit të shtetësisë do t'i pajisë ata me një dokument të ri të përshtatshëm udhëtimi.

Neni 9

1. Palët kontraktuese do të këmbëjnë specimenët e dokumenteve të vlefshme të tyre të udhëtimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kur njëra palë kontraktuese lëshon një model të ri të dokumentit të udhëtimit apo i modifikon dokumentet tashmë të këmbëra, për këto modifikime duhet të njoftohet pala tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së futjes në qarkullim të dokumentit të ri ose të modifikuar. Ky njoftim duhet të përfshijë modelin e dokumenteve të reja ose të modifikuara ashtu si edhe informacionin për zbatueshmërinë e tyre.

Neni 10

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve kontraktuese. Ndryshimet ose modifikimet e tilla do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të nenit 12 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11

1. Secila nga palët kontraktuese mund të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, veprimin e kësaj marrëveshjeje, në rastin e një fatkeqësie natyrore, epidemie apo për shkak të konsideratave të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së rendit publik, duke njoftuar menjëherë palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i veprimit të kësaj marrëveshjeje do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së këtij njoftimi.

2. Pala kontraktuese që ka marrë masat e treguara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të njoftojë menjëherë palën tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike për vendimin e tyre për ta shfuqizuar atë dhe për të rifilluar zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

1. Kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë të papërcaktuar kohore. Ato do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Secila prej palëve kontraktuese mund të përfundojë vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje ose pjesëve të saj, duke njoftuar me shkrim palën tjetër kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast marrëveshja ose pjesë të saj do të pushojnë së vepruari pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Podgoricë, më 6.11.2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe malazeze dhe anglisht, duke pasur secili nga tekstet fuqi të barabartë. Në rast të ndonjë paqartësie në interpretim, epërsi do të ketë teksti anglisht.

LIGJ
Nr.10 207, datë 23.12.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13 pika 1, emërtimi “Zyra rajonale e AKKP-së në qark” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik, në vijim AKKP, me qendër në Tiranë. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe përmbush këto përgjegjësi:

a) Përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohjen, kthimin e njohjen e së drejtës së kompensimit, të depozituara në ish-zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe, për të cilat nuk është marrë vendim nga këto zyra, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar:

i) tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi;

ii) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2 të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në nënndarjen “ii” më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të trajtimit të kërkesës për:

- rrëzimin e kërkesës;

- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kthimin a kompensimin e pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji.

b) Përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimimit.

Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

c) Përfundon shqyrtimin e ankimeve, që gjenden të depozituara në AKKP, nga Zyra e Avokaturës së Shtetit, për vendimet e njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Pas shqyrtimit e vlerësimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

ç) Përfundon shqyrtimin e verifikimit të vlefshmërisë ligjore të rasteve, për të cilat Drejtori i Përgjithshëm, me nismën e vet ose kryesisht, ka urdhëruar shqyrtimin e tyre. Pas vlerësimit e shqyrtimit, me nismën e vet ose kryesisht, të rastit të urdhëruar, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

d) Mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

dh) Vlerëson rekomandimet e autoriteteve të ngarkuara për monitorimin e zbatimit të ligjit.

Pas vlerësimit, sipas shkronjave “d” dhe “dh”, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

i) mosfillimin të procedimit të verifikimit të ligjshmërisë;

ii) fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe apo të vendimeve të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve në rrethe a bashki për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, duke vendosur:

- lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

e) Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

ë) Verifikon dhe llogarit detyrimet financiare, që i lindin shtetit për subjektet e shpronësuara ose për të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

f) Depoziton për regjistrim aktet e njohjes, të kthimit ose kompensimit të pronave dhe të të drejtave reale, të lidhura me to, në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. AKKP-ja, për ushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara në këtë nen, bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton sanksionet për shkelje të afateve dhe mospërgjegje me përgjegjshmëri nga institucionet që kanë në administrim pronën dhe informacionin ligjor për të.

3. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësisë për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, sipas këtij neni, duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv.

4. Ngarkohen zyrat e shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e vendimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

5. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AKKP-së, procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar, si dhe procedurat e afatet e komunikimit me institucionet shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Tarifat për procedurat e kthimit dhe kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Shqyrtimi i vendimit kryesisht

1. AKKP-ja përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, të kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

2. AKKP-ja mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat, për shkak të shkeljeve flagrante të ligjit të kohës, i bëjnë këto vendime absolutisht të pavlefshme.”.

Neni 4

Në nenin 17, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. AKKP-ja shqyrton kërkesën për kompensim jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit të saj.

Kërkesa e subjektit të shpronësuar depozitohet drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet postës dhe evidentohet në regjistrin e protokollit të institucionit. Subjekti pajiset me vërtetimin e regjistrimit të kërkesës.

I njëjti afat dhe e njëjta procedurë janë të vlefshme edhe për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësisë, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 15.”.

Neni 5

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Ankimi

Kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 6

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Transferimi i arkivit, logjistikës dhe mjeteve të punës

Veprimtaria e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe përfundon 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç zyrës së arkivit. Arkivi, mjetet e punës dhe logjistika e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, krijuar dhe administruar sipas ligjit, inventarizohen dhe i transferohen në përgjegjësi administrimi AKKP-së brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 7

Në nenin 24, data “30.6.2009” zëvendësohet me datën “31.12.2011”.

Neni 8

Aktet nënligjore, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6383, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 208, datë 23.12.2009

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8053, DATË 21.12.1995 “PËR KALIMIN NË PRONËSI,
PA SHPËRBLIM, TË TOKËS BUJQËSORE”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8053 datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, pas nenit 3 shtohen nenet 3/1, 3/2 dhe 3/3 si më poshtë:

“Neni 3/1

1. Përdoruesit e tokave bujqësore brenda vijave kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave urbane, që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompensohen me truall në pronësi brenda zonës urbane përkatëse në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

- a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë, sipërfaqja e truallit është 750m²;
- b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrat të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

2. Përdoruesit e tokës bujqësore brenda vijave kufizuese të zonës me përparësi turizmin, të përcaktuara sipas vendimit nr. 88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompesohen me truall në pronësi brenda zonës turistike përkatëse, në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

- a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë sipërfaqja e truallit është 750m²;
- b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrat të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

Neni 3/2

1. Kompensimi me truall në pronësi në komunën e Ksamilit bëhet në masën e përcaktuar në nenin 3/1 të këtij ligji dhe vetëm për familjet bujqësore e për individët:

- a) që figurojnë punonjës të ish-NB Ksamil në periudhën 1.8.1991 deri 1.10.1992;
- b) që kanë ardhur në ish-NB Ksamil nga 1.8.1991 deri në 4.5.1994, subjekte të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 21.2.1994 “Për dhënie toke në përdorim familjeve fshatare, banorë të ish-NB-së së Ksamilit”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 4.5.1994, të cilat plotësojnë kushtet e pikës 2 të këtij vendimi dhe që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji figurojnë banorë në gjendjen civile të Ksamilit.

2. Subjektet e përfshira në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni duhet të provojnë se nuk kanë përfutur tokë në pronësi nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Subjekteve të pikës 1 të këtij neni, nga sipërfaqja e kompensimit, sipas koeficienteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, u zbriten sipërfaqet e shesheve të ndërtimit, të fituara me vendime të komunës deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 3/3

1. Trojet e vëna në dispozicion për kompensim për përdoruesit e tokës bujqësore, sipas këtij ligji, përcaktohen:

a) në zonat turistike bregdetare, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore në territorin ku ndodhet trualli që kalon për kompensim;

b) në zonat periferike të qyteteve dhe qendrave urbane, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore në territorin ku ndodhet trualli që kalon për kompensim, pas përfundimit të procesit të legalizimit nga ALUIZNI.

2. Sipërfaqet e tokës në përdorim që lirohen nga përdoruesit, si pasojë e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, kalohen:

a) në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond fizik për kompensimin e subjekteve të shpronësuara, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fond i tokës bujqësore”, kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë bujqësore;

b) në pronësi të shtetit dhe administrohen sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për urbanistikën, kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë urbane.

3. Procedurat dhe autoriteti publik që bën kalimin në pronësi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6384, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 209, datë 23.12.2009

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 16 pika 3, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) investigimi i brendshëm antikorupsion.”.

Neni 2

Në nenin 40 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”.

2. Në fund të pikës 4 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Për personat, “të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant” dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie”, regjistrimi për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose çregjistrimi i tyre kryhet nga organet tatimore, sipas një procedure të veçantë, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 65, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklarave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.”.

Neni 4

Në nenin 68, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Shuma e detyrimit tatimor, e detyrueshme për t'u paguar, sipas deklaratës tatimore, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, vlerësohet si detyrim me vlerë zero dhe për shumën e tillë nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.”.

Neni 5

Pas nenit 105 shtohet neni 105/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 105/1

Struktura dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe të njësive të hetimit tatimor

1. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe njësitë e hetimit tatimor janë struktura të specializuara zbulimi, hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.

2. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe njësitë e hetimit tatimor kanë si mision parësor:

a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimeve të administratës tatimore, të cilat mund të përbëjnë vepra penale;

b) mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme për veprimtaritë e punonjësve të administratës tatimore qendrore, të cilat mund të përbëjnë vepër penale;

c) bashkërendimin e punës me prokurorinë, si hallkë ndërmjetëse, për vazhdimin e plotë të hetimit;

ç) shërbimin, si pikë kontakti, ndërmjet administratës tatimore dhe institucioneve të tjera, që kanë si funksion luftën ndaj korrupsionit.

3. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

4. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe ata të njësive të hetimit tatimor, që ushtrojnë funksionet e parandalimit, të zbulimit, ndjekjes dhe hetimit të plotë të veprave korruptive pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës. Miratimi i lejes jepet nga Ministria e Brendshme, vetëm pas autorizimit të lëshuar nga Ministri i Financave.

5. Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe të njësive të hetimit tatimor miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Në nenin 111, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Gjobat e vendosura për shkelje administrative, që lidhen me një detyrim tatimor, nuk mund të kalojnë 100 për qind të detyrimit tatimor.”.

Neni 7

Në nenin 114 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, fjalët “më e vogël se 10 000 lekë dhe” hiqen.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kjo gjobë zbatohet edhe në rastet kur tatimpaguesi ndryshon deklaratën fillestare, sipas kërkesave të nenit 67 të këtij ligji.”.

Neni 8

Në nenin 115 pika 1, fjalët “më e vogël se 10 000 lekë dhe” hiqen.

Neni 9

Neni 119 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 119
Mosdeklarimi i të punësuarve

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën 24 orë përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të papaguara, detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, kur është subjekt i biznesit të vogël dhe 100 000 (njëqind mijë) lekësh, për biznesin e madh me TVSH, për çdo rast mosdeklarimi.”.

Neni 10

Neni 122 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 122

Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:
 - a) nuk instalon pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë:
 - i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri në 10 ditë pune, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
 - ii) herën e dytë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, pas mosrespektimit të afatit të parë 10-ditor dhe kur për këtë pajisje është përcaktuar një afat vendosjeje tjetër deri në 10 ditë, pas vendosjes së gjobës së parë, sipas nëndarjes “i” të shkronjës “a” të kësaj pike, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë;
 - iii) pas kësaj periudhe, sipas nëndarjes “ii” të shkronjës “a” të kësaj pike, me pezullim të veprimtarisë deri në 6 muaj;
 - iv) në rastet e mosvendosjes së pajisjes fiskale, me mbyllje të plotë të veprimtarisë;
 - b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast:
 - i) për herën e parë, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
 - ii) për herën e dytë, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë;
 - iii) për herën e tretë, me mbyllje të veprimtarisë për 6 muaj;
 - c) lëshon një biletë, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj për kuponin tatimor, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
 - ç) lëshon kupon tatimor, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
 - d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster, që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit, për të kërkuar kupon tatimor, me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;
 - dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
 - e) nuk bën faturë për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve të ofruara, me dënim, sipas përcaktimeve të nenit 124 të këtij ligji;
 - ë) nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave, me dënim, sipas përcaktimeve të nenit 118 të këtij ligji;
 - f) nuk merr me qira apo nuk regjistron pajisje fiskale rezervë, në rastet kur ky ligj e parashikon si detyrim, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
 - g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale, me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këtë nen bëhen nga organet tatimore të juridiksionit, ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

3. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të përdorura në sektorë të ndryshëm, si transport, turizëm, art, kulturë etj., dënohet me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.”.

Neni 11

Në nenin 123 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Dënimet për shoqëritë e autorizuar dhe të paautorizuara”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale të subjektet e tjera tatimpaguese, pa qenë të licencuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndërsa shoqëritë që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale dënohen me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.”.

Neni 12

Në nenin 127, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje.

“3. Në rast se organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare, organet tatimore kanë të drejtë t'ia sekuestrojnë dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tij.”.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6385, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 210, datë 23.12.2009

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, në nenin 24, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rastet kur Këshilli i Ministrave vendos të ofrojë me koncesion pjesë apo të gjithë veprimtarinë, që lidhet me pullat e akcizës, përfshirë edhe kontrollin e tyre, atëherë kontrata koncesionare miratohet nga Kuvendi.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6386, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 211, datë 23.12.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 9, DATË
11.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE
BURIMET E FINANCIMIT TË SISTEMIT TË TACHOGRAPH DIGITAL NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të Tachograph Digital në Shqipëri”.

**Shpallur me dekretin nr.6387, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 18.1.2010
 Doli nga shtypi më 20.1.2010

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë